




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 489/18

496/18

497/38

Duke u bazuar në nenin 105, nenit 112.2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, si dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe nenin 18 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017, si dhe duke pasur parasysh kërkesën e Autoritetit Kontraktues /Komuna e Gjakovës/, me numër të protokollit: 489,496,497/18, të datës 24 shtator 2018, për heqjen e obligimit të pezullimit automatik, lidhur me tenderin “Ndërtimi i qarkorës së Gjakovës” me numër prokurimi 632/18/843/511, Kryetari i OSHP-së, me datë: 01 tetor 2018, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pabazuar kërkesa e AK-së /Komuna e Gjakovës/, për heqjen e obligimit të pezullimit automatik, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i qarkorës së Gjakovës ” me numër prokurimi 632/18/843/511.

II. MBETET, në fuqi obligimi i pezullimit automatik, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i qarkorës së Gjakovës” me numër prokurimi 632/18/843/511. Organi Shqyrtues i Prokurimit, do të vazhdojë me shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomik ankues në procedurë të rregullt, sipas dispozitave ligjore të LPP-së.

A r s y e t i m

Lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i qarkorës së Gjakovës ” me numër prokurimi 632/18/843/511, OSHP-ja, ka pranuar ankesat nga OE “PE-VLA-KU” Prishtinë, me nr. prot: 489/18, të dt.14.09.2018, OE “4 A-M” nga Tiranë-Shqipëri, me nr. te prot. 496/18 të datës 18.09.2018 dhe OE

N.T.SH “ Drini Kompany” me nr. te prot.497/18 të dt. 18.09.2018.

Me datën 14. 09. 2018, OSHP, ka njoftuar autoritetin kontraktues se kanë pranuar ankesat e lartpërmendura dhe e ka njoftuar se janë të obliguar konform nenit 112 të bëjnë pezullimin e aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i qarkores së Gjakovës” me numër prokurimi 632/18/843/511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës me datën 24. 09. 2018, i është drejtuar OSHP-së, me kërkesën për heqje të obligimit të pezullimit automatik, lidhur me aktivitetin e lartpërmendur të prokurimit duke i dhënë sqarimet si në vazhdim: “Arsyet për këtë kërkesë emergjente janë shumë dimensionale si:

Rrezikohet fondi prej 2.000.000,00 € i cili bartet në suficit, me ç’rast rrezikohet edhe përmbyllja komplet e qarkores së qytetit të Gjakovës, që tangon direkt në projektin e qarkores së Rrafshit të Dukagjinit.

Jemi në fazën e fillimit të punimeve të ndërtimit të kolektorit dhe impiantit të ujërave të zeza, donacion i KFË-Gjermane dhe Qeverisë Zvicrrane i cili arrin vlerën rreth 12.500.000,00 €meç’rast prolongimi i këtij projekti do të interferoj indirekt edhe në këtë projekt.

Poashtu në pranverën e vitit 2019 do të fillojë ndërtimi i Ngrohtores së qytetit të Gjakovës, donacion i Komisionin Evropian i cili arrin vlerën rreth 12.000.000,00 €, që

Lidhet direkt me infrastrukturën rrugore të “Ndërtimi i Qarkores së Gjakovës (lot 1)” dhe ndërtimin e kolektorit të Ngrohtores së qytetit.

Në rast të mos fillimit të Ndërtimi të Qarkores së Gjakovës(lot 1) këtë vit, si dhe në pranverën e vitit 2019 ndërtimi i kolektorit të Ngrohtores së Gjakovës do të kaloj ngjitur rruges “Petro Nini Luarasi”, ku pjesë e projektit të qarkores është edhe rrënimi i urës ekzistuese që lidh Gjakovën me Prizrenin dhe nuk ka asnjë rrugë alternative përveç rrugës “Petro Nini Luarasi”, atëher është i pamundur qarkulimi në komunikacion.

Gjithashtu më lejoni të ju njoftoj që jam i informur se Komisioni i Ri-vlerësimit, ka respektuar në përpikshmëri VENDIMIN e PSH-së nr 264,268,279,283,291/18, të datës 06/09/2018 dhe duke e respektuar nenin 1, paragrafm 1 të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Për informatën tuaj, dosja e këtij aktiviteti gjindet në Zyrat e OSHP-së, bashkangjitur i gjeni:

Memorandumin e Mirëkuptimit me nr, KM-MI 127/18 dhe KGj 413/01-1951 I cili është nënshkruar nga Ministri i Infrastrukturës z. Pal Lekaj dhe Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini me datë 01.02.2018

Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve

Zotimin në vlerë prej 2.000.000,00 € (i cili është i buxhetuar për vitin 2018), mbarim citati”.

OSHP me datën: 24. 09.2018, i ka njoftuar te gjithë operatorët ekonomik ankues se AK Komuna e Gjakovës ka kërkuar nga OSHP që te veprojnë në pajtim me nenin 112 paragrafi 2 të LPP-së, njeherit OSHP ka kërkuar nga të gjithë operatorët ekonomik ankues që të kthejnë përgjigje sa më shpejt që të jetë e mundur lidhur me prezantimin e argumenteve se përse pezullimi nuk duhet te hiqet sipas dispozitave te nenit 112.2 te LPP-së ku ndër të tjera thuhet **“Para se të marrë çfarëdo veprimi mbi kërkesën e autoritetit kontraktues, ankuesit do t’i jepet mundësia që t’i dorëzojë argumente me shkrim Kryetarit të OSHP-së, lidhur me atë se pse pezullimi nuk duhet të hiqet”**.

Te gjithë operatorët OE ankues përmes parashtrësive me shkrim kanë njoftuar OSHP-në se e kundërshtojnë fuqishëm kërkesën e AK-së për heqje të obligimit të pezullimit automatik duke dhënë argumentet e tyre dhe duke e cilësuar si të pabazuar dhe të paarsyeshme kërkesën e tillë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se kërkesa e AK-së, e për heqjen e pezullimit automatik për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i qarkores së Gjakovës” me numër prokurimi 632/18/843/511, nuk përmban arsye bindëse siç parashihet në neni 112. 2 të LPP-së, për faktin se arsyet e cekura nga AK-ja, në parashtrësën e datës 21.09.2018, nuk janë arsye bindëse dhe të mjaftueshme.

Duke e pasur parasysh kërkesën e Autoritetit Kontraktues /Komuna e Gjakovës të dt: 21.09.2018, konform nenit 112.2, të LPP-së, Kryetari i OSHP-së, e refuzon atë si të pa bazuar, për faktin se AK nuk ka arritur të dëshmojë se interesi publik për heqje të pezullimit automatik është më i madh se respektimi i afateve kohore për shqyrtim të ankesave, sidomos kur kemi parasysh faktin se autoriteti kontraktues si pasoj e keqmenagjimit dhe keqplanifikimit ka ardhur deri tek konkludimi nëse vonohen për realizimit te këtij projekti, nuk mund te kenë rruge alternative, ku do të bëhet e pa mundur qarkullimi i qytetarëve. Andaj për keqplanifikimin e projektit nga ana e zyrtareve përgjegjës të autoritetit kontraktues nuk mund të pësojnë operatorët ekonomik të cilët kanë parashtruar ankesat e tyre në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Me rastin e marrjes së këtij vendimi, kryetari i OSHP-së pati parasysh edhe numrin e operatorëve ekonomik ankues (gjithsejtë 3 operatorë ekonomik ankues), të cilët e kanë kundërshtuar fuqishëm kërkesën e AK-së, për heqje të obligimit të pezullimit automatik. Gjithashtu Kryetari i OSHP-së, pati parasysh që mundësia e dëmtimit të buxhetit të Kosovës, mund të jetë evidente dhe me pasoja të mëdha,

nëse eventualisht do të ndryshonte rezultati final, pas shqyrtimit të tri ankesave të operatorëve ekonomik, pasi që nëse hiqet obligimi i pezullimit automatik dhe nënshkruhen kontratat, e më pastaj nëse eventualisht ndonjë operatori ekonomik ankues do ti aprovohej ankesa, do të ndryshonte rezultati final, duke ardh në një situatë ku duhet të shkëputet kontrata, e të lidhet kontratë tjetër me operator ekonomik tjetër, atëherë dëmtimi i buxhetit të Kosovës do të ndodhte, për shkak të pakujdesisë dhe mos inicimit me kohë të aktivitetit të prokurimit nga ana e autoritetit kontraktues. Kryetari i OSHP-së sqaron se shqyrtimi në mënyrë të rregullt i ankesave nuk paragjykon rezultatin final të këtij aktiviteti të prokurimit.

Kryetari i OSHP-së, nga provat e prezantuara më lart, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura në afat prej 30 ditësh mund të ushtrojnë padi, pranë gjykatës themelore në Prishtinë – në departamentin për çështje administrative.

Kryetari i OSHP-së

Z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1. 1x1 AK- Komuna e Gjakovës
2. OE ankues.
3. 1x1 Arkivës së OSHP-së.